



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:253166
Datë: 12.12.2023
Numri i dokumentit: 05053619

C-IV-14-0694

Ankuesi

S M, U, Fushë Kosovë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 06 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN003-0008, datë 20 janar 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 7 shkurt 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN003-0008, datë 20 janar 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për tre paga të papaguara në shumë prej 1,800.00 € për një periudhë të pacaktuar kohore, nga NSH “Remont” (në likuidim). Ankuesi pohon se AL ka refuzuar kërkesën e tij si të pavlefshme për arsyet se pretendimi se tre pagat e fundit nga totali i pagave që mund të kenë mbetur të papaguara nga NSH, mirëpo nuk i njihet automatikisht kjo e drejtë të gjithë punëtorëve, pasi që kërkesa duhet të mbështetet me prova që konfirmojnë një detyrim të tillë të NSH-së. Ankuesi më tej pohon se siç pretendohet në arsyetim të vendimit ai nuk ka qenë në listën e pagave të dorëzuara nga NSH-ja për periudhën nga janari 2008 dhe se nuk ka qenë punëtor aktiv në momentin e privatizimit dhe se i njëjti nuk ka ofruar shërbime pune për NSH nga viti 1999. Ankuesi më tej pohon se pas vitit 1999 për shkak të situatës së krijuar nuk ka qenë në gjendje të kthehet në NSH në vendin e tij të punës. Ankuesi më tej thekson se fakti që kontrata për privatizimin e NSH është nënshkruar vetëm më 9 qershor 2011 (tri pagat e fundi që kërkoj janë pagat për muajt mars, prill dhe maj 2011 – tre muaj para privatizimit),

vërteton se kërkesa është brenda afatit dhe se në rastin e tij neni 608 i Ligjit për Punë të Bashkuar nuk mund të zbatohet. Ankuesi gjithashtu pohon se është diskriminuar. Ankuesi pohon se pret që gjykata të korrigjoj gabimet e bëra ndaj tij dhe në këtë rast të pranoj kërkesën e tij si të justifikuar dhe të ligjshme. Në mbështetje të ankesës së tij, ankuesi dorëzoi vetëm vendimin e kundërshtuar (në kopje).

Me 15 mars 2016, e paditura parashtrori mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore të zbatueshme gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura i përmbahet qëndrimit se kjo procedurë gjyqësore udhëhiqet vetëm nga ligjet në fuqi dhe jo nga faktorët personal, social, politik, filozofik dhe abstrakt. E paditura thekson rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas të cilit ankuesi ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i LPK dhe Neni 23 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033). Në lidhje me pretendimet për diskriminim e paditura pohon se objekt i vendimit të kundërshtuar këtu është vetëm kërkesa për pagat e pretenduara si të papaguara dhe nuk rezulton të jetë dorëzuar një kërkesë nga ankuesi tek AL e bazuar në diskriminim. Prandaj pretendimet për diskriminim, argumentet e ndërlidhura me të si dhe çfarëdolloj kompensimi i kërkuar si pasojë e saj janë irelevante për procedurën këtu. E paditura më tej pohon se AL ka bërë një vlerësim të saktë dhe të drejtë të kërkesës bazuar në ligjet në fuqi dhe nuk ka diskriminuar ndonjëherë ndonjë punonjës apo ish - punonjës të NSH-së në këto baza. Nëse ankuesi ndihet i diskriminuar, duhet të ketë ndjekë hapat e duhur ligjor përmes procedurave përkatëse për të marr kompensimin në bazë të diskriminimit, procedura të cilat janë të rregulluara me ligje të tjera dhe bien në kompetencë të gjykatave tjera, për rrjedhojë çfarëdo argumenti i bazuar në diskriminim është i papranueshëm për qëllimet e kësaj procedure gjyqësore. Neni 36.2.1 i Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se: *“elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. E paditura thekson se çdo kërkesë e ankuesit është e parashkruar sipas nenit 36.2.1. të Ligjit nr. 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar. Parashtruesi nuk kishte ndërmarr asnjë veprim ligjor brenda tre viteve nga viti 1999, prandaj të drejtat e tij janë të parashkruara tre vite më vonë në vitin 2002. E paditura më tej thekson se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi lidhur me dëmin që ai pretendon se ka pësuar duke mos përmbushur kështu detyrimin e tij për të dëshmuar dhe mbështetur pohimet e tij sipas nenit 7.1 të Ligjit 03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Pohimi i ankuesit për lartësinë e rrogës është thjesht deklarativ dhe nuk mbështetet nga asnjë dokument që dëshmon realisht se sa ka qenë rroga e tij e fundit dhe në cilën datë është marrë rroga e fundit nga NSH-ja. Për më tepër neni 40.1.6.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh që tre pagat e papaguara të punonjësve janë kërkesa prioritare dhe si të tilla kanë prioritet më të lartë. Megjithatë, ky nen nuk i njeh të gjithë punonjësve automatikisht të drejtën për tre paga, por i jep prioritet tre pagave të fundit që mund të kenë mbetur të papaguara nga totali i pagave që ndërmarrja nuk i ka paguar punonjësve. Në çdo rast, kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet me prova që vërtetojnë një detyrim të tillë të ndërmarrjes. Ky nen në vetvete nuk i njeh automatikisht të drejtën ndonjë punonjësi për kompensim me tre paga, andaj ankesa duhet të refuzohet mbi bazën që ankuesi nuk ka ofruar fakte që mbështesin kërkesën e tij dhe në këtë mënyrë nuk ishte në përputhje me nenin 23 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033. E paditura në mbështetje të ankesës së saj dorëzoi në kopje Vendimin për Fillimin e Likuidimit dhe Emërimin e anëtarëve të AL, datë 26 gusht 2013.

Me 15 gusht 2016, ankuesi dorëzoi përgjigjen e tij në mbrojtjen e të paditurës.
Me 31 gusht 2016, e paditura dorëzoi kundërpërgjigjen e saj.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRN003-0008, datë 20 janar 2014, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për tre paga të papaguara në shumë prej 1,800.00 € për një periudhë të pacaktuar kohore, nga NSH "Remont" (në likuidim). Në ankesën e tij kundër vendimit të kundërshtuar ankuesi thekson se NSH është privatizuar me 9 qershor 2011 andaj kërkon kompensim për tre paga të papaguara për muajt mars, prill dhe maj 2011, pra tre muajt e fundit para privatizimit të NSH-së, në shumën e njëjtë.

Në lidhje me kërkesën për tre pagat e papaguara për periudhën e lartcekur (mars, prill dhe maj 2011), ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi relevante që dëshmon ekzistencën e marrëdhënies së tij të punës me NSH dhe as dëshmi të tjera në lidhje me përvojën e tij të punës apo çfarëdo dokumenti apo listë të punëtorëve që do të mund të dëshmonte kohën e saktë të punësimit dhe stazhin e tij të punës respektivisht momentin kur është punësuar dhe për sa kohë ka qenë punëtor i NSH-së. Dëshmia e vetme e dorëzuar në këtë rast nga ankuesi është vendimi i kundërshtuar i cili si i tillë nuk është relevant për themelësinë e kërkesës së ankuesit për paga të papaguara për

periudhën objekt kontesti. Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi nuk kishte parashtruar prova relevante as në procedurën e likuidimit tek AL, për të mbështetur besueshmërinë e kërkesës së tij në lidhje me pagat e papaguara si dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shumën mujore e as lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi edhe vet ka deklaruar se pas vitit 1999 për shkak të situatës së krijuar nuk ka qenë në gjendje të kthehet në NSH në vendin e tij të punës dhe rrjedhimisht nuk ka punuar në NSH.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara për muajt mars, prill dhe maj 2011, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Për më tepër ankuesi ka dështuar që të parashtojë prova relevante në mbështetje të kërkesës së tij edhe pas mbrojtjes së të paditurës për përgjigje.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të ankuesit në lidhje me kërkesën e tij për paga të papaguara veçanërisht pretendimeve të ankuesit në lidhje me kërkesën e tij për paga të papaguara mbi bazën e diskriminimit por gjen se të njëjtat janë vetëm pretendime përgjithësuese dhe nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar, prandaj si të tilla dhe refuzohen.

Kërkesën për tre (3) paga të papaguara në shumë prej 1,800.00 €, gjykata e gjen si të pabazuar edhe për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në (nr. 04/L-034), neni 40.1.6.1, i referohet vetëm prioritetit të tre (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat, por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar